



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi  
Mbledhja nr. 05-2008  
Prishtinë, më 19 mars 2008, ora 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C- 203

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

**Në mbledhje morën pjesë:** Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Ramadan Gashi, Selvije Halimi, Bajram Kosumi, Kolë Berisha, Riza Smaka, Adem Hajdaraj, Džezair Murati.

**Munguan:** Branislav Grbiq, Melihate Tërmkolli.

**Të ftuarit:** Lumnije Murati-ZPK, Ramadan Islami-OSBE, Lejla Selimi-OSBE, Ramadan Islami-OSBE, Reshit Gashi-NDI, Fitore Zeneli-KDI, gazetarë të RTK-së.

**Nga stafi i Komisionit:** Idriz Tahiri, Drita Çarkaxhiu, Behlul Zeka dhe Sulltane Gashi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit, me këtë:

**REND DITE**

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 7 marsit 2008
3. Shqyrtimi i Projektligjit për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë
4. Shqyrtimi i Projektligjit për përfitimet e ish-zyrtarëve të lartë

5. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e mjedisit
6. Shqyrtimi i Projektligjit për organizmat e modifikuar gjenetikisht
7. Shqyrtimi i Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis
8. Shqyrtimi i Projektligjit për përdorimin civil të eksploziveve
9. Shqyrtimi i Projektligjit për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore
10. Të ndryshme

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetari**-Përshëndeti anëtarët e Komisionit, përfaqësuesit e organizatave që e mbështesin Komisionin dhe stafin e Komisionit. I njoftoi të pranishmit për propozimin e rendit të ditës dhe propozoi që në pikën të ndryshme të diskutohet në lidhje me çështjen e Rregullores së punës për komisionet dhe për çështjen e Ombudspersonit.

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 7 marsit 2008**

**Kryetari** - Pyeti anëtarët për vërejtje eventuale për procesverbalin.

**Riza Smaka** - Tha se ka vërejtje për procesverbalin. Ai kërkoi që procesverbali të jetë më përmbajtësor dhe të pasqyrojë më gjerësisht diskutimin e anëtarëve. Me këtë rast ka vërejtje lidhur me miratimin e Projektligjit për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Nuk kam votuar kundër miratimit të këtij Projektligji, por vetëm kam dhënë vërejtje se Projektligji i tillë i shkel parimet themelore, u jepet primat ndërmarrjeve të vogla dhe të mesmeve, mirëpo nuk kam votuar kundër.

*Procesverbali u miratua me vërejtjen e Riza Smakës.*

**Kryetari**-Tha se në orën 12:00 do të marrë pjesë në një takim të kryetarëve të komisioneve me Kryetarin e Kuvendit dhe i pyeti anëtarët e Komisionit nëse kanë ndonjë çështje për ta ngritur në këtë takim.

**Riza Smaka**-Propozoi të ngrihet çështja e sigurimit të pagesave për angazhimin e ekspertëve në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, në mënyrë që të kemi ligje cilësore në Republikën e Kosovës.

### 3. Shqyrtimi i Projektligjit për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë

Raportuesi i caktuar të raportojë për këtë Projektligj. Riza Smaka i paraqiti vërejtjet e veta. Mungoi përfaqësuesi i ftuar i Zyrës së Kryeministrit. Riza Smaka raportoi për Projektligjin dhe i paraqiti propozimet e veta për nenet e Projektligjit. Komisioni i miratoi propozimet. Në bazë të këtyre propozimeve do të hartohet raporti i amendamentuar për nenet e shqyrtuara.

**Kryetari**-Theksoi se duhet amendamentuar edhe më sidomos duhet të ndalemi të përmbajtja e këtij Projektligji. Duhet të shikohen “deputetët dhe të emëruarit e tyre”, “nënkryetarët e Kuvendit”, “Kryeshefi ekzekutiv”-nuk ka më kryeshef, tash ka drejtor të personelit. *Anëtarët e tjerë të familjes* - është shumë e gjerë - duhet një amendament i ri. Gjithashtu duhet shikuar edhe një herë: “deklarimi pas shkarkimit”, “tarifat tre mijë euro, pasuria e luajtshme” edhe vetura është e luajtshme dhe mund të shkojë nga tre mijë deri në tridhjetëmijë euro.

**Adem Hajdaraj**-Tha se praktikohet edhe më tej të thuhet ligji.

**Adem Salihaj**-Theksoi se gabimet gjuhësore janë shumë të pranishme. Shumë nga ligjet tona përkthehen nga gjuha angleze dhe përkthyesit nuk arrijnë t’i formulojnë mirë fjalitë. Ai sqaroi se me Ligjin për komunat janë caktuar edhe nënkryetarët, ndërsa sa i përket nenit 3 duhet të qartësohet çështja nëse bëhet fjalë për Kryetarin dhe anëtarët e Kryesisë. Ai më tutje shtoi se përfaqësuesit e Qeverisë, të ftuar në Komision, është mirë të vijnë të përgatitur, sepse ndryshe vetëm shkaktojnë vonesa nëse thonë se do t’i sjellim vërejtjet pas dy javësh.

**Selvije Halimi**-Theksoi se është mirë që në të ardhmen referuesit t’i sjellin vërejtjet e tyre në formë të amendamenteve dhe në pastaj i miratojmë. Nëse vazhdojmë ndryshe, do të humbasim shumë kohë dhe shtoi se duhet të ndërpriten praktikatat e mospranisë së zyrtarëve të Qeverisë ose të ministrive. Duke u ndërlidhur me Projektligjin, theksoi se ky ligj i cenon të drejtat e njeriut dhe se vetëm mbi bazën e dyshimit duhet të kërkohet deklarimi edhe nga anëtarët e tjerë të familjes.

**Bajram Kosumi**-Tha se i përkrah vërejtjet e referuesit, por do të ishte mirë t’i kemi edhe të shkruara. Më tutje shtoi se nëse i bëjmë të gjitha vërejtjet amendamente, atëherë nga njëzet nene do të na dalin dyqind amendamente, prandaj vërejtjet e së njëjtës natyrë duhet t’i përfshijmë në një amendament. Për shembull të gjitha vërejtjet në të cilat thuhet të shkruhet me shkronjën e madhe L, të jenë nën një amendament dhe ato ligjore nën një amendament tjetër. Ai propozoi të hartohet një doracak i shprehjeve gjuhësore për juristët dhe për hartuesit e ligjeve, ndërsa në lidhje me nenin 3 të Projektligjit, theksoi se sipas Ligjit dihet mirë se çka është familja, pra nuk flitet për bashkësi.

**Adem Salihaj**-U pajtua se është më mirë që vërejtjet të paraqiten edhe me shkrim. Kjo do ta bënte punën më efektive, ku secili referues i paraqet amendamentet e tij dhe Komisioni vendos për apo kundër miratimit të tyre.

**Kryetari**-Theksoi se kuvendet komunale nuk do të kenë nënkryetarë.

**Ramadan Gashi**-Tha se fjala është për nënkryesues, për më tepër duhet të konsultohet Ligji për qeverisjen lokale.

**Selviqe Halimi**-Tha se përveç vërejtjeve edhe amendamentet duhet të bëhen me shkrim, ndërsa përfaqësuesi i Qeverisë duhet të japë sqarime se çka ka menduar me këtë Projektligj.

**Kryetari**-Tha se ne duhet t'i sjellim vërejtjet me shkrim, kurse në formë të amendamentit i përgatisin juristët e administratës.

#### **4. Shqyrtimi i Projektligjit për përfitimet e ish-zyrtarëve të lartë**

**Kryetari**-Propozoi që javën e ardhshme për këtë Projektligj të referojë anëtari i Komisionit, Kolë Berisha.

*Propozimi u miratua njëzëri.*

*Shqyrtimi i projektligjeve për bazën juridike në Kornizën Kushtetuese*

Pikat e rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e mjedisit
6. Shqyrtimi i Projektligjit për organizmat e modifikuar gjenetikisht
7. Shqyrtimi i Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis
8. Shqyrtimi i Projektligjit për përdorimin civil të eksploziveve;
9. Shqyrtimi i Projektligjit për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore.

**Kryetari**-Theksoi se duke u bazuar në përgjegjësitë e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë, të parashtruara në kreun 5.1 dhe në kreun 9.1.26(a) të Kornizës Kushtetuese vlerësojmë se Projektligji për mbrojtjen e mjedisit, Projektligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe Projektligji për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore kanë bazë juridike në kreun 5.1 (f) të Kornizës Kushtetuese. Projektligji për organizmat e modifikuar gjenetikisht ka bazë juridike në kreun 5.1(j) dhe

Projektligji për përdorimin civil të eksploziveve ka bazë juridike në kreun 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese.

*Projektligjet u miratuan njëzëri nga anëtarët e Komisionit dhe u kërkua që të përgatiten rekomandimet.*

## **10. Të ndryshme**

**Kryetari**-Tha se javën e ardhshme do të caktohet paneli për Ombudspersonin.

Kryetari i falënderoi edhe një herë të pranishmit dhe e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

*Procesverbalin e hartoi:*  
Behlul Zeka, zyrtar ligjor

Kryetari i Komisionit

---

Bahri Hyseni